



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim

09 Nr.

Datë

PLANI I PUNËS
i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim
për vitin 2011

Vushtrri, 2010

Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim, veprimtarin e vetë e bazon në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03 /L- 040 të datës 20.02.2008 ,, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal”, nr. 03 / L- 049, të dates 13.03.2008 si dhe Statutin e Komunës së Vushtrrisë nr. 612/ 08 të dates 30.10.2008.

Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim, gjatë vitit 2011 planifikon një bashkpunim edhe më të ngusht me Ministrin e Tregëtis dhe Industrisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministrin e Bujqsisë dhe institucione tjera relevante të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2011 Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim planifikon që të përmbush obligimet eveta me përgjegjësi në lëmin e Ekonomis, Bujqësis dhe Pylltaris.

Sektori I Biznesit

Gjatë vitit 2011 Drejtoria per Ekonomi Bujqesi dhe Zhvillim planifikon hapjen e Qendres Komunale të Biznesit (QKB).

Qendra Komunale e Biznesit është planifikuar që të hapet në fund të muajit janar 2011 apo në fillim të muajit shkurt.

Stafi për QKB është trajnuar dhe qertifikuar nga Agjencioni – Kompania e cila është zgjedhur nga Banka Botërore, në bashkpunim me Ministrin e tregëtis dhe Industrisë.

Themelimi I QKB –së në komunën tonë do të ndikoj pozitivisht tek bizneset sepse të gjitha punët e tyre do të kryhen në komunë e jo në Prishtinë ku për qdo ndryshim është dashur të shkohet disa herë për të regjistruar apo për të paraqitur për ndonjë ndryshim në biznesin e tyre.

QKB – ja do të krijoj mundësin që komuna të ketë qasje direkte në të gjitha bizneset të cilat afarizmin e vete të ushtroj në komunën e vet.

Në QKB – në parashihet që të kryhen punët rreth regjistrimit, shuarjes , shtimin e veprimtarive ndrrim adrese dhe qdo informat tjetër që ka të bëjë me bizneset. Po ashtu këtu do të kryhen lejet afariste për biznese si dhe licensat profesionale për biznese, d.m.th. QKB – ja do të krijoj mundësin që të gjitha bizneset që ushtrojn afarizëm në komunën tonë të kryhen shërbimet në një afat shumë më të shkurtër dhe pa shpenzime shtesë dhe duke kursyer kohe për shkuarje në Prishtine disa herë për rregullim të dokumentacionit.

Gjatë vitit 2011 planifikohet që ne bashkpunim edhe me Drejtorin për Buxhet, Thesar dhe Financa, Drejtorin per Inspektion si dhe Drejtorin per Urbanizem që shumica e bizneseve të paisen me leje komunale të punës.

Gjatë vitit 2011 Drejtoria per Ekonomi, Bujqesi dhe Zhvillim, planifikon që të gjitha bizneset të cilat ushtrojn veprimtari në territorin e komunës sonë të paisen me :

- Leje afariste komunale
- Leje profesionale

Me Leje Profesionale do të paisen bizneset të për të cilat nevojitet të kete licensë profesionale siq janë: mjekët, stomatologët, avokatët, kontabilistët etj.

Tregu – Gjatë vitit 2011 parashihet që Tregun e Gjelbërt ta udhëheq kompania e cila është fituese e tenderit.

Gjatë vitit 2011 planifikohet një bashkpunim më I gushtë me:

- Agjencionin Kosovar për regjistrimin e bizneseve të MTI, që njëkohsishtë është bazë e QKB – ve,
- Administratën tatimore të Kosovës – Zyra Regjionale e Kosovës në Mitrovicë,
- Ministrin e Ekonomis dhe Financave – Sektorin e Licencave,
- me Drejtorin për Inspektion, DBTHF, Drejtoris për Urbanizën si dhe Drejtorit tjera me qëllim të harmonizimit të punëve.

Planifikimi I projekteve

Gjatë vitit 2011 Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim planifikon të ketë një zyre të projekteve në të cilën do të kryheshin këto punë:

- Pranimin e kërkesave të qytetarëve për projekte
- Planifikimin e projekteve
- Analizën dhe vlersimin e projekteve
- Propozimin e projekteve kapitale
- Listën e projekteve të zhvilluar dhe projekteve që priten për realizim
- Informata me kohë për procesin në të cilën gjenden projektet
- Raport pune në qdo gjashtë muaj
- E të tjera varsisht nga dinamika dhe koha - nevoja që kërkon

Pylltaria - Gjatë vitit 2011 parashihet

- pastrimi, rrallimi I pishave në Bukogllav në 30ha
- Sllakoc, kroj i pejëve 30 ha, dhe Baqkë 10ha
- Qyqavica I, II, III , pastrim, rrallim 100ha
- Oblovik te pishat, pastrim sanitar 80 metra kub
- Qukë e Skoqnës, prerja e rregullt 100ha
- Pastrim, rrallim Sekilaq, Gorulak, Llanak 50ha

Pyllzimi në terene në pronë publike

- Tereni Qyqavic, pyllzim me pishë hormoq 10ha
- Tereni quk e Skoqnës, studime dhe Pasomë 30ha me pshë të bardh dhe të zezë.

Plani për pyje private

- Kërkesë për pyje private 250 copë për masë drusore zjarri 1200 m kubë.

- Pyllëzimi me fidane pishë 10ha Skromë.

DREJTORIA PËR EKONOMI,BUJQËSI DHE ZHVILLIM

Sektori për bujqësi

PLANI VJETOR I PUNËVE DHE AKTIVITETEVE PËR VITIN 2011

Gjatë vitit 2011 në kuadër të sektorit për bujqësi do të kemi një vazhdimësi të bashkëpunimit të përhershëm me të gjithë akterët që mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme në zhvillimin e sektorit të bujqësisë,si janë: MBPZHR,OJQ-të e jashtme dhe vendore,donatorët e ndryshëm,fermerët prodhues apo përpunues të produkteve bujqësore,kompaninë ujitëse,shërbimet veterinare,pastaj grupet dhe shoqatat e ndryshme të fermerëve,institucionet kreditore si dhe me të gjitha organet tjera komunale, me një përkushtim të përbashkët që të kemi një zhvillim në të gjitha lëmit bujqësore të komunës sonë.

Angazhimet e përbashkëta me Ministrinë e Bujqësisë

Viti 2010 ishte në vazhdimësi edhe një vit i fillimit të përkrahjes së fermerve përmes granteve dhe subvencioneve të ndryshme në disa sektor të bujqësisë,dhe duke pasur parasysh se një përkrahje e tillë, ndoshta edhe më e madhe do të vazhdojë edhe në vitin 2011, ne do të jemi shumë të përkushtuar në ofrimin e informatave dhe përgatitjen e aplikacioneve apo projekteve të ndryshme për fermerët tanë,të cilët i plotësojnë kriteret për të përfituar nga grantet apo subvencionet e MBPZHR.

Do të jemi të angazhuar në realizimin e projekteve të cilat do t'i financoji MBPZHR,e që kanë të bëjnë me rehabilitimin e Sistemit të ujitjes,përkatesisht riparimin e një stacioni të pompimit në fshatrat Pantinë, rregullimi i të cilit do të ketë një ndikim shumë të rëndësishëm për ujitjen e kulturave bujqësore,e me këtë edhe në ngritjen e prodhimit bimore dhe përmirësimin e cilësisë së kulturave bujqësore.

Planifikimi e realizimi i mbjelljeve,korrje-shirjeve dhe statistikat bujqësore

-Do të punojmë në planifikimin dhe përcjelljen e mbjelljeve pranverore dhe atyre vjeshtore,duke ofruar edhe këshilla profesionale për fermerët me qëllim të rritjes së prodhimit dhe përmirësimit të cilësisë së produkteve bujqësore.

-Përgatitja për fushatën e korrje-shirjes së drithrave dhe përcjellja e sajë,duke u angazhuar që procesi i korrje-shirjes të shkoji sa më mirë,pa probleme dhe të përfundoj sa më shpejtë në mënyrë që humbjet të jenë sa më të vogla e të grumbullohet drithi me cilësi të lartë.

-Angazhimet në plotësimin e Anketës administrative statistikore,që ka të bëjë me sipërfaqet me kultura bujqësore dhe rendimentet e tyre,pastaj me numrin e kafshëve dhe prodhimet blegtorale. Të dhënat e

grumbulluara përkitazi me planifikimin e realizimin e mbjelljeve, korrje-shirjeve, vjeljeve dhe statistikave bujqësore do t'i dërgohen MBPZHR. Pastaj grumbullimi i të dhënave nga 14 ferma për plotësimin e librave të fermës, prkatësisht futja e këtyre të dhënave në Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave të Kosovës, punë e cila vazhdon në kontinuitet.

Angazhimet në mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve

-Përcjellja e gjendjes fitosanitare të bimëve gjatë vegjetacionit dhe ofrimi i njohurive profesionale për masat që duhet ndërmarr në rastet konkrete, nëse paraqiten sëmundje apo dëmtues dhe baroja të këqija që rrezikojnë prodhimin bujqësor.

-Bashkëpunimi me Shërbimet veterinerë-stacionet veterinerë me qëllim të përkujdesjes për gjendjen shëndetësore të kafshëve shtëpiake dhe parandalimin apo evitimin e sëmundjeve eventuale që do të mund të paraqiteshin.

Shërbimet këshillimore

-Ofrimi i shërbimeve këshilluese për fermerët dhe bashkëpunimi me Departamentin për Zhvillim Rural dhe Shërbime Këshilluese të Ministrisë së Bujqësisë, nga i cili do të presim përkrahje në këtë drejtim, në fushat në të cilat do të kemi nevojë.

-Dhënia e asistencës profesionale fermerëve, shoqatave apo grupeve të fermerëve, kooperativave të fermerëve etj, për përgatitjen e projekteve të ndryshme në lëminë e bujqësisë, dhe sigurimi i informatave për të aplikuar në projekte të ndryshme që do të përkrahin lëminë e bujqësisë, format dhe mënyrat e kreditimit të bizneseve bujqësore nga institucionet kreditore, mbajtja e shënimeve në ferma, menagjimi më i mirë i fermave etj.

Përcjellja e tregut furnizues me impute bujqësore

-Do të përcjellim tregun e furnizimit me impute bujqësore, sidomos me farëra dhe plehra minerale gjatë sezonave të mbjelljeve pranverore e vjeshtore, duke u dhënë informacione dhe sugjerime fermerëve për llojet më të mira të farërave dhe të imputeve tjera bujqësore me qëllim të ngritjes së prodhimit të bujqësore brenda sipërfaqeve egzistuese.

Redukimi i qenve endacak

-Përgatitja e planit për eliminimin e qenve endacak dhe përcjellja e aksioneve të reduktimit të tyre. Redukimi do të bëhet me qëllim të zvoglimit të rrezikut të qytetarëve, e sidomos të fëmijëve nga sulmet eventuale të qenve endacak.

Planifikimi i buxhetit/projekteve për vitin 2011

Sektori	Lloji i investimit	Buxheti (€)		
		Komuna	Fermerët	Totali
Blegtori	a)Ofrimi i pajisjeve për ftohje të qumshetit,makinave mjelse dhe mjete higjenike për përmirësim të kualitetit të qumështit,në ferma të lopëve qumështore/përfitues 20 fermer	6.720,00	3.280,00	10.000,00
	b) Furnizimi i katër fermerëve me makina për sillazhë/4 makina sillazhi	8.920,00	5.080,00	14.000,00
Pemtari	Ngritja e 5 plantacioneve me dredhëza me sipërfaqe nga 10 ari, nga i cili përfitojnë 5 fermerë	8.220,00	1.780,00	10.000,00
Perimi-kulturë	a) Ngritja e 6 serrave për kultivimine perimeve me sipërfaqe prej 1 ari/përfitues 6 fermer	9.620,00	2.380,00	12.000,00
	b) Instalimi i sistemit të ngrohjes në dy serra, tek dy prodhues të materialit fidanor të perimeve	9.320,00	2.680,00	12.000,00
Tjera	Eliminimi i qenve endacak	6.000,00		6.000,00
	Vaksinimi i qenve shtëpiak	6.000,00		6.000,00
Projektet në bashkfinancim me donatorët e mundshëm		15.000,00		15.000,00
Gjithësejt		69.800,00	15.200,00	85.000,00

Do të kryhen edhe detyra tjera të cilat do të ipen nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim.

Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim
Nasuf Aliu